

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Rasim Rasimi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefserë Berisha procesmbajtëse, në çështjen penale të dënuarit Sh.I., nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.34/1 datë 10.03.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.269/2017 datë 18.07.2017 në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20.02.2018, mori këtë

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Sh.I., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-DKR, PKR.nr.34/2015 datë 10.03.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.269/2017 datë 18.07.2017.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-DKR, me aktgjykimin PKR.nr.34/2015 datë 10.03.2017, të dënuarin Sh.I. e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1000(njëmijë) € të cilin dënim është obliguar ta paguajë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast mospagese i njëjti do të shndërrohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € të dënimit do t'i llogaritet një ditë burg. Është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 €. Të dënuarit konform nenit 62 par 1,2 dhe pika 2,7 të KPRK-së i është shqiptuar dënimi plotësues sekuestrimi i armëve dhe atë, një armë gjuetie dy tuteshe-vertikal prodhimi amerikan, me nr. serik 15206 kal.12 GA, një armë gjysmë automatike e prodhimit gjerman, me nr. serik 560948 kal.12 GA një pistoletë me gas e llojit Zecol jackadual2 kal.9 mm, me nr. serik EJ97002.60 copë fishekë me gas të kal. 9 mm si dhe një thikë patentë.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr. 269/2017 të datës 18.07.2017. është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve në afat ligjor mbrojtësi i të dënuarit, avokati Rr.L., nga Gj., ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë ti anuloj dhe lëndën për vendim të ri ose rigjykim ta kthej në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.203/2017 të datës 31.10.2017 ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPPK dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërsa e mbrojtësit të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit Sh.I., av. Rr.L., pretendohet se të dy aktgjykimet janë marrë me shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit. Më tej në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë theksohet se nuk është kontestuese se i pandehuri të ketë pas në shtëpinë e tij dy armë dhe atë një armë të gjuetisë dy tytshë –vertikal, prodhim amerikan me nr. serik 15206, kal 12 GA, një armë gjysmë automatike, prodhim gjerman me nr, serik 560948 kal 12 GA 118 copë fishek të kal. 12 GA ,një rrethatore për vendosjen e fishekëve të kalibrit 12 GA, një pistoletë me gas të llojit “ Escol JackaDual” kal 9 mm, 60 copë fishek me gas 9 mm, një gëzhojë e fishekut me gazë të kalibrit 9 mm.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendohet se armët kanë qenë të regjistruara, po ashtu të vendosura në vendin e sigurt në cilin nuk ka pasë qasje askush. Pretendohet se sipas ligjit për armë nuk është paraparë apo rregulluar mënyra e vazhdimit të lejeve për armë, dhe kjo ka qenë arsyeja pse është drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kur dihet se nga ana e të dënuarit Sh.I. ka qenë tërë dokumentacioni për të bërë vazhdimin e lejes nga ana e institucionit përkatës.

Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë Gjykata Supreme kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore të paraqitura në kërkesë dhe në këtë rast këto pretendime kanë të bëjnë kryesisht me vërtetimin e gjendjes faktike e konform dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për këtë bazë ligjore.

Megjithatë, kjo gjykatë për të verifikuar aplikimin e drejt të ligjit penal, vërtetojë se në faktet vendimtare e që janë se i dënuari më parë ka poseduar leje për dy armët e gjuetisë të cilave leje ju ka skaduar afati, për njëren armë në vitin 2010, kurse për armën tjetër në vitin 2011, kurse në momentin e konfiskimit të tyre nuk ka poseduar leje, do të thotë se i dënuari armët e gjuetisë i ka mbajtur pa leje më shumë se 4 vite.

Gjykata Supreme vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa pretendimi i mbrojtësit se me aktgjykimet e lartëcekura është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, po ashtu nuk qëndron, ngase të dy gjykatat

kanë bërë vlerësimin e drejtë të gjitha provave që janë administruar në shqyrtim gjyqësor për çka kanë dhënë arsyetim të drejtë dhe ligjor.

Nga të gjitha këto që u tha më lart, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit, andaj kërkesa e mbrojtësit të dënuarit është refuzuar si e pabazuar dhe konform nenit 437 të të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 20.02.2018, Pml.nr.297/2017

Procesmbajtëse,  
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,  
Nesrin Lushta